



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr. 273, Datë 26.08.2020

PËR  
CAKTIMIN ME SHORT TË RELATORIT PËR ZHVILLIMIN E PROCEDIMIT  
DISIPLINOR NR.1/2020, TË FILLUAR NË NGARKIM TË MAGJISTRATIT {...}, ME  
DETYRË GJYQATAR NË GJYKATËN E RRETHIT GJYQËSOR KORÇË

Këshilli i Lartë Gjyqësor, duke u bazuar në nenin 147/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 63të ligjit nr.115/2016 *“Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”*, të ndryshuar, nenet 138 dhe vijues të ligjit nr. 96/2016 *“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”*, të ndryshuar, me propozim të Komisionit Disiplinor,

V E N D O S I :

1. Caktimin e anëtarit të Komisionit të Disiplinës z. {...} në cilësinë e relatorit për procedimin disiplinor nr. 1/2020 në ngarkim të magjistratit {...}, me funksion gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë.
2. Ky vendim i njoftohet Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe magjistratit {...}, brenda 5 ditëve nga marrja e tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjektit.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR